

# **MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

## **NDËRMJET**

### **AKADEMISË DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

## **DHE**

### **AKADEMISË DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, më poshtë të quajtura "Palë",

Të vendosura për të rritur dhe forcuar bashkëpunimin ndërmjet tyre, me qëllim formimin, trajnimin dhe kualifikimin e diplomatëve respektivë,

Bien dakord si më poshtë:

#### **Neni 1**

Palët nënshkruese të këtij Memorandumi do të bashkëpunojnë për krijimin e bazës dhe kushteve ligjore, për shtimin e kontakteve dhe punës studimore, në kuadrin e programeve dhe veprimtarive të ndërsjella.

#### **Neni 2**

Përparësitë e këtij bashkëpunimi do të jenë si më poshtë:

1. Trajnimi dhe përmirësimi i nivelit të kualifikimit për diplomatët e rinj dhe jo vetëm, në fushat e studimeve dhe praktikave mbi:
  - a) Studimet mbi politikën e jashtme,
  - b) Marrëdhëniet Ndërkombëtare,
  - c) Të Drejtën Ndërkombëtare,
  - d) Marrëdhëniet Ekonomike Ndërkombëtare dhe Rajonale,
  - e) Shkenctat politike, sociale dhe disiplina të tjera, veçanërisht ato të studimeve historike dhe studimeve albanologjike;

2. Shkëmbim i ndërsjellët informacioni mbi çështje shkencore, metodologjike dhe praktike.

### **Neni 3**

Palët do të realizojnë bashkëpunimin nëpërmjet:

1. Programeve të kurseve bazë dhe kurseve të posaçme;
2. Shkëmbimeve të diplomatëve, lektorëve, ekspertëve, kërkuesve shkencorë dhe studiuesve;
3. Kërkimeve dhe botimeve të përbashkëta akademike;
4. Bashkëpunimit në përgatitjen e punimeve kualifikuese, akademike dhe monografike;
5. Shkëmbimit të burimeve shkencore dhe botimeve.

### **Neni 4**

Format, kohëzgjatja dhe kushtet financiare të shkëmbimit dhe trajnimit të përfaqësuesve të palëve, do të realizohen mbi bazën e reciprocitetit dhe për to do të ketë marrëveshje shtesë, ndërmjet Palëve.

### **Neni 5**

Diplomatët e Palëve mund të marrin pjesë në konferenca, simpoziume, seminare shkencore dhe tryeza të rumbullakëta që do të zhvillohen. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën mbi këto veprimtari.

Ato do të nxisin organizimin e konferencave dhe simpoziumeve, zhvillimin e kërkimeve të përbashkëta akademike dhe realizimin e projekteve me interes të përbashkët.

Palët do të bashkëpunojnë në kuadrin e forumeve dhe organizatave ndërkombëtare, ku ato janë të përfaqësuara.

### **Neni 6**

Palët do të miratojnë organizimin e ligjëratave dhe kumtesave nga ekspertë të ministrive respektive, si dhe nga palë të treta, për auditorë akademikë mbi çështje me interes të përbashkët.

### **Neni 7**

Për zbatimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi dhe përpunimin e projekteve do të ngarkohet një grup pune, i bashkë kryesuar nga përfaqësuesit e caktuar nga Palët.

### **Neni 8**

Grupi i Përbashkët i Punës do të evidentojë përparësitë dhe do të rekomandojë projektet për realizimin e të cilave do të hartohen protokolle dhe shtojca të posaçme.

### **Neni 9**

Dispozitat e këtij Memorandumi Bashkëpunimi mund të ndryshohen më pëlqimin paraprak, me shkrim, të Palëve.

### **Neni 10**

Modalitetet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi do të shqyrtohen ndërmjet Palëve nëpërmjet konsultimeve.

### **Neni 11**

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe mbetet i vlefshëm derisa njëra nga Palët do të njoftojë Palën tjetër, me shkrim, 3 muaj përpara, në rrugë diplomatike, për përfundimin e tij.

Nënshkruar në Tiranë, më 6 janar 2015, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, të dy njëllor të vlefshëm.

**PËR AKADEMINË DIPLOMATIKE  
TË MINISTRISË SË PUNËVE TË  
JASHTME  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**PËR AKADEMINË DIPLOMATIKE  
TË MINISTRISË SË PUNËVE TË  
JASHTME  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Skënder DURMISHI  
Drejtor

Anila BITRI LANI  
Drejtor